



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz-së Sekretariat@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org  
Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 23 të Rregullores së Punës së KQZ-së, si dhe duke u bazuar në vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës të datës 21.06.2017, për shpalljen e Zgjedhjeve Lokale të datës 22 tetor 2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 05.07.2017, nxjerr këtë:

### VENDIM

#### Për zgjatjen e orarit të punës për anëtarët e KQZ-së dhe stafin e SKQZ-së

- I. Miratohet zgjatja e orarit për ditët e punës, për anëtarët e KQZ-së dhe stafin e Sekretariatit të KQZ-së, duke filluar nga ora 08:00 deri në ora 18:00.
- II. Orari i punës për ditën e shtune dhe të diele do të jetë nga ora 9:00 deri në ora 16:00.
- III. Përveç obligimeve nga pika I dhe II e këtij vendimi, stafi i SKQZ-së obligohet të jetë prezent në punë, gjatë mbledhjeve të KQZ-së, Këshillave dhe aktiviteteve tjera.
- IV. Obligohen departamentet/divizionet që përveç pikën I dhe II të këtij vendimi, bazuar në fazat dhe angazhimet sipas afateve ligjore të parapara, të qëndrojnë në vendin e punës deri në përfundimin e aktiviteteve.
- V. Obligohet personeli i KQZ/SKQZ-së që ditën e zgjedhjeve të datës n tetor 2017, në jenë prezent në vendin e punës, deri në përfundimin e aktiviteteve të parapara me planin operacional të ditës së zgjedhjeve.
- VI. Obligohet Kryeshefi Ekzekutiv i SKQZ-së për ndërmarrjen e procedurave administrative , me qëllim të zbatimit të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim, hyjnë në fuqi më 13.07.2017

#### Arsyetim

Duke u bazuar në vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës, të datës 21.06.2017 për shpalljen e Zgjedhjeve Lokale, për 22 tetor 2017, zgjatja e orarit të punës bëhet për shkak të rritjes së nivelit të aktiviteteve, afateve të ngjeshura, me angazhim shtesë deri në përfundim të aktivitetit të paraparë me planin Operacional, dhe me qëllim të përmbushjes së obligimeve që dalin nga Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, Rregullat Zgjedhore të KQZ-së, Rregulloren e Punës të KQZ-së, Rregulloren për Organizimin e Sekretariatit të KQZ-së dhe Plani Operacional, lidhur me përgatitjet për zgjedhjet lokale, që do të mbahen më datën 22 tetor 2017, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 05.07. 2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

  
Valdete Daka